



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

KOLEGJI ZGJEDHOR

Nr. Regj. Them.13

Data e regjistrimit 14.06.2019

Nr. i Vendimit 12

Data e vendimit 24.06.2019

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

KRYESUES SEANCE: Tomor SKRELI
ANËTAR: Lindita SINANAJ
ANËTAR: Artur MALAJ
ANËTAR: Ridvan HADO
ANËTAR: Shkëlqim MUSTAFA

Asistuar nga *sekretare gjyqësore Eranda Cufo*, në Tiranë, sot më datë 24.06.2019, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike çështjen që u përket palëve:

PADITËSE: Partia Uniteti Kombetar, përfaqësuar në gjykim nga Kryetari i Partisë Z.Idajet Beqiri.

I PADITUR: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizimin nr.12148 prot, datë 24.06.2019, nga Erion Meta dhe Olsi Peto.

OBJEKTI: Kundërshtimi i Vendimit nr.836 date 13.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me anën e të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për tu çregjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 Qershorit 2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 64, 65, 72, 73,145, 152 e vijues të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoji përfaqësuesin e palës paditëse, Partisë Uniteti Kombëtar, Z.Idajet Beqiri që në diskutimin e tij përfundimtar kërkoi:

- x *Pranimin e kërkesëpadisë.*
- x *Shfuqizimin e Vendimit nr.836 date 13.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me anën e të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për tu çregjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 Qershorit 2019.*

Përfaqësuesin e palës së paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që në diskutimin e tij përfundimtar kërkoi:

- x *Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.*

Dhe vlerësoi çështjen në tërësi:

VËREN

Me Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 në mbështetje të neneve 92/gj dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 9/1/2 dhe 10/1/2 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008,

“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën 30.06.2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Paditësi, “Partia Unitetit Kombëtar”, me germa nistore (PUK) në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor është regjistruar nga Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Me vendimin nr. 37 datë 11.03.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka vendosur regjistrimin e paditësit, Partia Uniteti Kombëtar (PUK), me kryetar z.Idajet Beqiri, dhe shkronja nistore “PUK”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Pala paditëse PUK, bashkë me disa parti politike të regjistruara rregullisht si subjekte zgjedhore, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, janë regjistruar nga KQZ-ja si koalicion zgjedhor në shkallë vendi, nën emrin Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Me dekretin nr. 11199, datë 10.06.2019 Presidenti i Republikës ka shfuqizuar Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” duke anuluar datën 30.06.2019 si datë të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar” (PUK), pasi është njohur me qëndrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të bërë publik në mbledhjen e datës 10.06.2019 ku, KQZ, pasi vlerësoi se Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm vendosi të vijojë më tej me përgatitjet për zgjedhjet e datës 30.06.2019, nëpërmjet Kryetarit të saj z. Idajet Beqiri, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u çregjistruar nga procesi zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 13.06.2019 ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit zgjedhor PUK dhe, në përfundim të shqyrtimit administrativ, me Vendimin nr.836 datë 13.06.2019 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së “Partisë Uniteti Kombëtar” për

çregjistrim nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019 dhe heqjen e emrit nga fletët e votimit, të Partisë Uniteti Kombëtar”.

KQZ në Vendimin nr.836 datë 13.06.2019 arsyeton se kërkesa e “Partia Uniteti Kombëtar” ka një premisë fillestare, që konsiston në analizën e bazës ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 (posaçërisht Dekretin nr.11199 datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës), si edhe një element thelbësor, që lidhet me të drejtën e subjektivit zgjedhor për t’u çregjistruar nga procesi zgjedhor dhe heqjen e emrit të tij nga fleta e votimit.

Në lidhje me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.11199, datë 10.06.2019 “Për shfuqizimin e dekretit nr.10928, datë 5.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, KQZ, rithekson qëndrimin e tij të deklaruar publikisht në mbledhjen e datës 10.06.2019, se “... ky dekret është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa “a” të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), sipas të cilit: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik”, pasi:

Dekreti i dytë ka shkelur hapur dhe në mënyrë flagrante një dispozitë urdhëruese të ligjit e konkretisht, sipas parashikimeve të Kushtetutës, neni 92, germa gj, Presidenti “cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve”.

Ndërkohë, sipas parashikimeve të Neneve 93 dhe 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete. Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të (neni 94). Pra, sa më sipër, Presidenti i Republikës ka kompetencë (vetëm) të caktojë datën e zgjedhjeve. Çdo veprim tjetër i tij, që ka për pasojë mosushtrimin e kësaj kompetence, është i pavlefshëm.

Ndërsa Kushtetuta sanksionon se cili organ ka kompetencën e caktimit të datës së zgjedhjeve, është Kodi Zgjedhor që parashikon mënyrën se si përcaktohet data e zgjedhjeve, konkretisht sipas parashikimeve të neneve 9 dhe 10 të tij.

Kështu, sipas Nenit 9 të Kodit Zgjedhor, “2. Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve ... jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit.”

Kushtetuta, në nenin 65 të saj prezanton konceptin e “periudhës zgjedhore”, i cili detajohet nga Kodi Zgjedhor kur parashikon në nenin 8 shprehimisht se: “Zgjedhjet ... për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen ... brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor.”

Mbështetur mbi gjithë këtë bazë kushtetuese dhe ligjore, KQZ sjell në vëmendje se, kompetenca e Presidentit mbi procesin zgjedhor lidhet vetëm me caktimin datës e zgjedhjeve, sipas rregullave të mirë përcaktuara nga ligji. Dekreti i Presidentit, del ekskluzivisht në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit; ai nuk mund të rregullojë përtej urdhërimeve të tyre. Mbështetur mbi këtë bazë ligjore është edhe dekretimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, dekretim i cili duhet bërë brenda kornizës ligjore të Kodit Zgjedhor. Dekretimi duhet bërë duke respektuar periudhën zgjedhore (neni 8); dekretimi duhet bërë jo më vonë se 9 muaj përpara mbarimit të mandatit të të zgjedhurve vendorë... (neni 9). Presidenti i Republikës ka kompetencë të kufizuar në kohë dhe, tej kësaj kohe, ai nuk ka më asnjë kompetencë për të vepruar në këtë drejtim. Pra, as mund të ndryshojë dhe as mund të shfuqizojë datën e zgjedhjeve. Vetëm një ndryshim me ligj mund të lejojë ndryshimin apo të shfuqizimin e datës së zgjedhjeve, sikurse ka ndodhur në vitin 2007.

Të dyja këto parashikime të Kodit Zgjedhor nuk janë respektuar në nxjerrjen e dekretit të dytë, për rrjedhojë, janë momente që e bëjnë dekretin e dytë të Presidentit të Republikës të jetë në shkelje të hapur dhe në mënyrë flagrante me dispozitat ligjore të cituara më sipër.

Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës vjen haptazi ndesh me *parimin e ligjshmërisë*, të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ... dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.”

Ndërkohë që nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve është kompetencë e Presidentit, ai ka diskrecion vetëm të caktojë një datë brenda “periudhës zgjedhore”, por jo të shkojë përtej kësaj periudhe apo, aq më tepër, të mos caktojë fare datë e zgjedhjesh, sikundër rezulton tashmë kur, me një dekret të dytë, u shfuqizua Dekreti nr.10928, datë 05.11.2018 “Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019” dhe u anulua data e zgjedhjeve 30.06.2019.

Neni 22 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “Kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, Ushtrimi i tyre është i detyrueshëm.”

Duke e lënë vendin pa datë zgjedhjesh, Presidenti i Republikës me vetëdije të shpallur refuzon të zbatojë urdhërimin Kushtetues të parashikuar nga neni 92, pika “gj”, që e detyron të caktojë datën e zgjedhjeve. Kompetenca e një organi publik nuk është një e drejtë, por një detyrë të cilën legjislacioni ia ka ngarkuar organit përkatës që ta ushtrojë, dhe ta ushtrojë brenda kufijve të diskrecionit të njohur nga ligji.

Sipas nenit 1 të Kushtetutës, “3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme *e periodike*”, kurse sipas nenit 109 po aty, “organet përfaqësuese [dhe ekzekutive] të njësive bazë të qeverisjes vendore zgjidhen *çdo katër vjet*”.

Shfuqizimi i dekretit që përcakton datën 30.06.2019 si datë për zgjedhjet e organeve vendore, është një shkelje e hapur dhe flagrante e parashikimeve të mësipërme kushtetuese dhe ligjore.

Në rastin konkret, periodiciteti është cenuar. Cenimi i këtij parashikimi bie ndesh edhe me nenin 3 “E drejta për zgjedhje të lira” të Protokollit shtesë të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore Paris, 20.III.1952, ku parashikohet shprehimisht se “Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore zgjedhje ...”. Sa më sipër, në mbështetje të nenit 109, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës “Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni”, parashikim i cili, nëpërmjet dekretit të dytë vlerësojmë se është cenuar. Kujtojmë, se në përputhje me parashikimet e nenit Neni 122, paragrafi 1 dhe 2 i kushtetutës, “Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”

Çdo ndryshim i datës së zgjedhjeve çon në zgjatjen e mandatit të organeve vendore, gjë e cila është e ndaluar. Kjo zgjatje, bie ndesh me detyrimin kushtetues të periodicitetit të zgjedhjeve. Sovraniteti i takon popullit dhe populli e ushtron atë përmes zgjedhjeve. Presidenti, KQZ, etj., janë organe publike që me veprimtarinë e tyre, mundësojnë procedurat praktike për realizimin e sovranitetit. Këto organe publike nuk mund të bëhen pengesë me veprimet apo mosveprimet e tyre. Kjo, jo vetëm është e palejueshme nga ligji, por është antiligjore.

Në respekt të Nenit 110 të KPA, “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.” Çdo subjekt publik a privat që ndesh një akt të tillë nuk i nënshtrohet rregullave të tij dhe nuk e merr parasysh gjatë veprimtarisë së tij.

Për pasojë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i vetëdijsëm se nuk është ai organi publik që mund të shfuqizojë një akt administrativ të një organi tjetër publik, në pozitën e “organit që është

kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative” (ankimin administrativ) sipas pikës 2 të nenit 110 të KPA, “ka detyrimin ligjor të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ” Dekretit nr.11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës (sipas detyrimit që parashikon neni 111 i KPA). KQZ e konsideron këtë dekret sikur nuk ekziston. Në mbështetje të parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë organi më i lartë shtetëror i përhershëm i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë, duke u njohur edhe me aktin në fjalë, e konstaton atë si absolutisht të pavlefshëm, nul, sikur nuk ekziston dhe vijon punën për realizimin me sukses të procesit zgjedhor për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor të datës 30.06.2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vendimin nr.836 datë 13.06.2019 referon edhe te Rezoluta e Kuvendit të Republikës. e datës 13.06.2019, sipas të cilës:

“Kuvendi i Shqipërisë mbështet qëndrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor dhe inkurajon këtë organ të vijojë të mbrojë pacenueshmërinë si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019 nisur si rrjedhojë e zbatimit të Dekretit të Presidentit nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke e njohur këtë të fundit si të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019.

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje të gjitha organeve publike që ngarkohen nga ligji me detyra në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të Qershorit 2019 të konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit datë 10.06.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.”

Përsa i përket kërkesës, në lidhje me çregjistrimin e kërkuarit-subjekt zgjedhor nga gara për zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019 si dhe të heqjes së emrit të partisë “Partia e Uniteti Kombëtar”, siglës, shkronjave nistore “PUK” dhe emrit të kryetarit të partisë, z.Idajet Beqiri, nga përmbajtja e fletës së votimit të prodhuar për zgjedhjet në fjalë, KQZ në vendim vlerëson se kjo kërkesë është e pa bazuar në ligj, passjell pasoja të rënda për procesin zgjedhor dhe duhet rrëzuar me këto argumente:

“Legjislatori nuk ka parashikuar përsa i përket mundësisë së tërheqjes së partive politike (e në përgjithësi të subjekteve zgjedhore) pas regjistrimit të tyre nga KQZ dhe miratimit të listave shumememore të kandidatëve. Ka një maksimum të gjithë pranuar të së drejtës, sipas së cilës, në parim, legjislatori konsiderohet se është i arsyeshëm. Për pasojë, KQZ vlerëson se mungesa e këtij rregullimi specifik nuk është *ometim* legjislativ, por mungesë e qëllimshme e vullnetit të legjislatorit për të parashikuar një lejim të tillë. KQZ, duke kujtuar se Kodi Zgjedhor është përpara së gjithash një akt normativ me natyrë të theksuar procedurale, thekson se, ndryshe nga e drejta materiale, sipas së cilës “çdo gjë që nuk ndalohej, lejohet”, në të drejtën procedurale, “çdo gjë që nuk lejohet, ndalohej”.

Lejimi për t’u çregjistruar nga gara zgjedhore, veçanërisht pasi procesi i shtypjes së fletëve të votimit ka përfunduar, do të vinte ndesh edhe me parimin e sigurisë juridike dhe do të cenonte të drejtat e fituara nga subjektet e tjerë pjesëmarrës në zgjedhje, të cilëve do t’u mohohesh padrejtësisht e drejta e marrjes pjesë në zgjedhje, pasi heqja/fshirja e emrit të një subjekti zgjedhor është e mundur vetëm përmes shkatërrimit të plotë të të gjitha fletëve të votimit ku gjendet subjekti në fjalë. Fare pak ditë përpara datës së zgjedhjeve është objektivisht e pamundur për KQZ të realizojë procedura të reja prokurimi dhe të printojë (përmes operatorit ekonomik fitues) fletë të tjera votimi pa kredencialet e subjektit politik që ndryshon vullnet për të marrë pjesë në zgjedhje. Procedura e re me patjetër nënkupton edhe shpenzime monetare të tjera, duke qenë se fletët e votimit kanë një kosto të caktuar, të konsiderueshme. Për më tepër, lejimi i këtij precedenti mund të hapë rrugë që ai të përsëritet edhe nga subjekte të tjerë zgjedhorë, me pasojë afatshkurtër shtyrjen e procesit zgjedhor dhe pasojë afatgjatë banalizimin e tij.

Duke përfunduar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjykon se kjo qasje e adoptuar prej tij është konform parimit të proporcionalitetit, pasi nuk krijon asnjë pasojë negative të pariparueshme për subjektin zgjedhor kërkues. Ndërhyrja në lirinë e subjektit, nëse perceptohet si e tillë, merr në vlerësim të gjitha rrethanat e tjera shumë të rëndësishme dhe, në këtë balancë, iu jep atyre përparësi, me qëllim realizimin e zgjedhjeve dhe forcimin e demokracisë pluraliste në Shqipëri.”

Kjo vendimmarrje e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është ankimuar nga subjekti zgjedhor PUK, pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesëpadi për kundërshtimin e vendimit nr.836, datë 13.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me argumentin se:

“Vendimi i KQZ ... është marrë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor, pasi kushdo merr pjesë në zgjedhje, voton dhe garon lirisht, sikurse tërhiqet po lirisht prej tyre, posaçërisht në kushtet kur procesin zgjedhor e deformojnë dhe e cenojnë institucionet e rëndësishme të shtetit, sikurse është Presidenti i Republikës. Vendimmarrja e KQZ-së duket se detyron elektoratin dhe vet subjektin zgjedhor kërkues që të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të qershorit 2019, ndërkohë që gara duhet të jetë e lirë dhe jo detyruese.”

II.

Vlerësimi i Kolegjit Zgjedhor :

Kolegji Zgjedhor, pasi ia nënshtroi çështjen debatit gjyqësor, dëgjoi palët, administroi provat, në konsideratë të fakteve të rezultuara nga provat e marra në gjykim, arriti në përfundimin që padia e paraqitur nga PUK rezulton e pabazuar në prova dhe në ligj dhe se, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 836, datë 13.06.2019 është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve si dhe në zbatim të drejtë të ligjit, dhe për pasojë padia duhet rrëzuar.

Referuar nenit 145/1 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor çmon se paditësi, Partia e Unitetit Kombëtar, duke qenë një nga subjektet zgjedhorë që janë regjistruar rregullisht e në përputhje me Kodin Zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019 gëzon të

drejtën për të ankimuar vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kur çmon se ato cenojnë interesat e saj të ligjshëm, sipas afateve të përcaktuara në nenin 152 këtij Kodi.

Në rastin konkret Partia e Unitetit Kombëtar ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 836, datë 13.06.2019, brenda afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor në nenin 152.

Paditësi kundërshton vendimin objekt kërkesëpadie me pretendimin se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shkelur Kushtetutën dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor, pasi, në kushtet kur procesi zgjedhor është deformuar nga Dekreti i Presidentit të Republikës, KQZ sërish nuk lejon subjektet zgjedhore të tërhiqen nga zgjedhjet.

Kolegji vëren se shkak për të cilin kërkuuesi ka adresuar kërkesën për çregjistrim pranë KQZ-së ka të bëjë me një moment të ri faktik, i cili lidhet me nxjerrjen e Dekretit nr. 11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës për anulimin e datës 30 qershor si datë e dekretuar më parë për zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2019, ndaj Kolegji çmon të ndalet së pari në analizën e këtij shkak i cili paraqet rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky fakt i ri nuk përbën premisë për pranimin e kërkesës për çregjistrim, por si i tillë, analizohet në tërësinë e rrethanave ligjore dhe faktike në të cilat ndodhet procesi zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor vlerëson perputshmërinë e Dekretit nr. 11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës me Kodin Zgjedhor, duke marrë në konsideratë edhe vendimin nr. 150 datë 16.06.2017 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast kërkuuesja Partia “Forca Rinia” i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës si antikushtetues duke paraqitur këto pretendime :

= Dekreti i dytë i Presidentit të Republikës është antikushtetues, pasi Presidenti i Republikës e kishte ushtruar një herë këtë të drejtë, bazuar në nenin 8 dhe 9 të Kodit Zgjedhor dhe nuk kishte asnjë shkak kushtetues për ta ndryshuar atë, pavarësisht marrëveshjes politike midis partive.

= Data e re e zgjedhjeve e caktuar me dekretin e ri është antikushtetuese, pasi është tej afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

= Dekreti i Presidentit të Republikës ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ndryshoi pa asnjë shkak të ligjshëm një pritshmëri ligjore për subjektet zgjedhore dhe zgjedhësit.

Me Vendimin nr. 150, të datës 16 qershor 2017, Gjykata Kushtetuese e ka cilësuar “**akt individual administrativ**” dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se :

*Për sa i takon legjitimitet racione materia, Kolegji vlerëson se Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131 dhe 134 të Kushtetutës, merr në shqyrtim në shkallë të fundit kërkesat që drejtohet kundër akteve të pushtetit publik që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se akti ndaj të cilit është ushtruar ankim, **dekreti i Presidentit të Republikës, i cili është një akt administrativ individual, pasi ka për objekt vetëm caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.** Për këtë arsye, Kolegji çmon se ky akt nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate por në juridiksionin e gjykatave administrative dhe për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate me objektin sipas kërkesës.*

Përputhja apo jo e dekretit të Presidentit të Republikës me dispozitat e Kodit Zgjedhor nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në juridiksionin e gjykatave administrative apo, sipas rastit, të Kolegjit Zgjedhor dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë.

Në themel të vendimarrjes së KQZ-së është fakti se Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës është një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi si në akt administrativ individual vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

Kolegji Zgjedhor mban në konsideratë edhe Vendimin nr. 150, të datës 16 qershor 2017, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese i cili ka deklaruar moskompetencën e Gjykats Kushtetuese në një rast të ngjashëm. Është e vertetë se ky vendim është i kolegjit të përbërë nga tre gjyqtarë dhe

jo i mbledhjes së gjyqtarëve, por nga ana tjetër Kolegji Zgjedhor mban parasysh se sipas nenit 31/1/a të Ligjit nr. Nr.8577, datë 10.2.2000 “ Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese ne Republikën e Shiperisë”, **ky lloj vendimi merret pikërisht nga kolegji dhe jo mbledhja e gjyqtarëve.** Neni 33/1/a parashikon se:

“Vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga kolegji merret njëzëri, ndërsa nga Mbledhja e Gjyqtarëve merret me shumicën e votave.

Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur:

a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese”.

Në analizë të vendimit objekt kundërshtimi dhe shqyrtimit të provave të administruara në gjykim, Kolegji çmon si të drejtë dhe të bazuar në ligj vlerësimin e KQZ-së se Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 është një akt absolutisht i pavlefshëm. Në bindjen e Kolegjit Zgjedhor, ky Dekret i dytë, i cili shfuqizon Dekretin e datës 05.11.2018 “Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019” është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa “a” të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) , sipas të cilit: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik”.

Më konkretisht, kompetencat e Presidentit të Republikës ushtrohen nga pikëpamja formale me anë të dekretit siç parashikon neni 93 i Kushtetutës. Ky përcaktim kushtetues plotësohet më tej nga dispozita të veçanta të shpërndara në Kushtetutë apo edhe në ligje të tjera, e në këtë aspekt Presidenti sipas nenit 92, germa “gj”, të Kushtetutës ka kompetencë caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumëve. Kjo kompetencë lidhur me datën e zgjedhjeve është e vetmja si e tillë e shprehur në rendin ligjor shqiptar, thënë kjo duke konsideruar edhe situatën rregullatore të Kodit Zgjedhor, i cili në asnjë dispozitë të tij nuk parashikon kompetenca të tjera përveç sa është parashikuar në Kushtetutë. Aspektet e vetme që rregullohen nga nenet 64 e vijues të këtij kodi lidhen me afatet dhe përcaktimin e periudhës zgjedhore.

Kolegji vëren se, në mungesë të një kompetence të shprehur në ligj, çdo veprim tjetër tej kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji, bie ndesh jo vetëm me një dispozitë urdhëruese sikurse është neni 94 i Kushtetutës ku parashikohet se “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerrja në pajtim me të”, por edhe me jurisprudencën e vetë Gjykatës Kushtetuese. Kështu, konkretisht, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin e saj nr. 15/2010¹, me objekt “Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën e Shqipërisë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, ka theksuar se:

“34. Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës, në nenin 92 të Kushtetutës përcaktohen kompetencat e Presidentit të Republikës...”²

Për më tepër, referuar neneve 8, 9 dhe 10 të Kodit Zgjedhor, parashikohet pa ekuivok se:

Neni 8

“Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor.”;

Neni 9

¹ Për më shumë shiko Vendimi nr. 15, datë 15.04.2010 (V – 15/10), paragrafi 34.

² Vendimi i GJK shqiptare nr.14, dt.21.07.2008.

“2. Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve ... jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit.”

Neni 10

“1. Data e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës. Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, Presidenti zbaton rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij Kodi. 2. Për efekt të këtij Kodi, mandati i organeve të qeverisjes vendore mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së shpalljes me vendim të KQZ-së në shkallë vendi të rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”

Kolegji çmon të bazuar qëndrimin e KQZ-së ku shprehet në vendim se: “dekretimi duhet bërë duke respektuar *periudhën zgjedhore* (neni 8)”, dhe se dekretimi duhet bërë *jo më vonë se 9 muaj ...* (neni 9)”. Presidenti i Republikës ka kompetencë të kufizuar në kohë, dhe tej kësaj kohe, ai nuk ka më asnjë kompetencë për të vepruar në këtë drejtim. Pra, as mund të ndryshojë dhe as mund të shfuqizojë datën e zgjedhjeve. Të dyja këto parashikime të Kodit Zgjedhor nuk janë respektuar në nxjerrjen e dekretit të dytë, për rrjedhojë, janë momente që e bëjnë dekretin e dytë të Presidentit të Republikës të jetë në shkelje të hapur dhe në mënyrë flagrante me dispozitat ligjore në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa “a” të Kodit të Procedurave Administrative.

Vetëm ligji mund ta lejojë që Presidenti të ndryshojë apo të shfuqizojë datën e zgjedhjeve, sikurse ka ndodhur në vitin 2007, kur Kuvendi u detyrua të ndryshojë Kodin Zgjedhor për të mundësuar këtë. Pra, në vitin 2007, germa “gj”, e nenit 92, të Kushtetutës nuk e lejonte Presidentin që të caktonte datë e zgjedhjeve tej afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, dhe për këtë, u bë ndryshimi në Kodin Zgjedhor për t’i mundësuar Presidentit caktimin e një date zgjedhjesh lokale tej afatit të përcaktuar në nenet 7 dhe 8 të Kodit Zgjedhor që ishte në fuqi në vitin 2007. Ligjvënësi në Kodin Zgjedhor të miratuar me ligjin nr.9087 date 19.06.2003 parashikoi **një dipozitë të posacme**, pikërisht në nenin 181/1 ku në pikën 1 përcaktohej : *Për zgjedhjet vendore te vitit 2007, Presidenti i Republikës, pavaresisht nga percaktimet e bera ne nenin 7 pika 8 te ketij Kodi, ne ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, ricakton datën e zhvillimit te zgjedhjeve, jo me vone se data 20 shkurt 2007.*

Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji Zgjedhor çmon se Presidenti i Republikës, nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019, në mungesë

të kompetencës ligjore dhe tej afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, ka marrë kompetencat e një organi tjetër, konkretisht ka marrë kompetencat e Kuvendit të Shqipërisë. Në kushtet kur është Kuvendi organi që ka parashikuar afatet dhe rregullat e përcaktimit të datës së zgjedhjeve përmes parashikimeve të Kodit Zgjedhor, çdo ndryshim i mundshëm i tyre, në mungesë të delegimit, duhet të bëhet vetëm nga ky organ, pra vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë.

Gjithashtu, Kolegji Zgjedhor çmon se anulimi i datës së zgjedhjeve në mungesë të kompetencës ligjore dhe në shkelje të afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor bën që në fakt, shtetasve shqiptarë me të drejtë vote t'iu mohohet një e drejtë kushtetuese e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur sipas nenit 45 të Kushtetutës.

Ky fakt bie ndesh edhe me parashikimet e Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias e konkretisht me pikën 1, votimi universal, duke parashikuar se Votimi universal konsiston në të drejtën elektorale aktive (e drejta për të votuar) si dhe pasive (e drejta për t'u zgjedhur). E drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur mund t'i nënshtrohet një numër kushtesh, të cilat jepen më poshtë. Kushtet më të zakonshme janë ato që kanë të bëjnë me moshën dhe kombësinë.

Mohimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur bie ndesh me Parimet bazë të trashëgimisë Elektorale Evropiane. Kështu, sipas pikës 3 dhe 4 të Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, "3. Për të qenë në përputhje me parimet e përbashkëta të trashëgimisë kushtetuese Evropiane, të cilat përbëjnë bazën e çdo shoqërie të vërtetë demokratike, zgjedhjet duhet të respektojnë pesë rregullat bazë themelore: votimi duhet të jetë universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë, dhe i drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të zhvillohen në mënyrë periodike. Të gjitha këto parime së bashku përbëjnë trashëgiminë elektorale Evropiane. 4. Megjithëse këto parime janë të një natyre konvencionale, zbatimi i tyre është i lidhur me një sërë çështjesh, të cilat duhet t'i nënshtrohen një analizë të thellë. Është mirë që të identifikojmë "thelbin" e këtyre parimeve, të cilat duhet të respektohen me rigorozitet nga të gjithë vendet Evropiane. 5. Thelbi i trashëgimisë elektorale Evropiane përbëhet përgjithësisht nga rregullat

ndërkombëtare. Rregulli përkatës universal është Neni 25 (b) i Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike, i cili sanksionon në mënyrë të shprehur të gjitha këto parime, me përjashtim të votimit të drejtpërdrejtë, megjithëse edhe kjo nënkuptohet. 1 Rregulli i përbashkët Evropian është Neni 3 i Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parashikon në mënyrë të shprehur të drejtën për zgjedhje periodike me votim të 1 Shih Nenin 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. CDL-AD (2002) 23 rev - 14 - lirë dhe të fshehtë;2 parimet e tjera janë konfirmuar gjithashtu në çështjet gjyqësore për të drejtat e njeriut. 3 E drejta për zgjedhje të drejtpërdrejta është pohuar gjithashtu nga Gjykata e Strasburgut, të paktën në mënyrë të tërthortë. 4 Megjithatë, parimet kushtetuese, të cilat janë të përbashkëta për të gjithë kontinentin, nuk janë sanksionuar vetëm në dokumentet ndërkombëtarë: përkundrazi, ato përmenden shpesh më hollësisht në kushtetutat kombëtare. 5 Konvergimi i legjislativëve dhe praktikave të vendeve të ndryshme kontribuon në identifikimin e parimeve të përbashkëta. 6. Shpeshësia e zgjedhjeve - Zgjedhjet duhet të zhvillohen në periudha të rregullta kohore.³

Nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve bëhet edhe zgjatja e mandatit të organeve të qeverisjes vendore tej afatit ligjor, e një gjë e tillë është e papranueshme, pasi bie ndesh me nenin 1, pika 3 dhe nenin 2, pikat 1 e 2 të Kushtetutës. Për arritjen e këtij përfundimi Kolegji Zgjedhor ka në konsideratë edhe rregullimet ligjore për marrëdhënie analoge në fushën e së drejtës publike. Kështu, sipas këtyre normave të së drejtës objektive, për një kategori funksionarësh të lartë (për shembull Prokurori i përgjithshëm, KLP dhe KLGJ, Kushtetuta dhe ligji respektiv parashikon afate kohore për fillimin e procedurave për zëvendësimin e tyre përpara përfundimit të mandatit, pikërisht për të respektuar këtë të fundit.

Praktikisht, në nenin 29 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se:

Neni 29

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

³ Për më shumë shiko vendimin nr. 39, datë 27.07.2015 të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, *jo më vonë se 4 muaj përpara mbarimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm*, shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, procedura fillon menjëherë.

Po kështu, neni 9 i ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon, se:

Neni 9 Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

Jo më vonë se 4 muaj nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë në detyrë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Lartë shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nën të njëjtën logjikë është edhe parashikimi i nenit 107 “Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, kur parashikon shprehimisht se:

1. *Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve prokurorë në detyrë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*, Prokurori i Përgjithshëm shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Për sa më sipër, referuar në nenin 111 të Kodit të Procedurave Administrative ku parashikohet se “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”, Kolegji Zgjedhor çmon se KQZ-ja, në cilësinë e organit publik të përkufizuar në po këtë Kod, kur me vendimmarrjen e tij objekt kundërshtimi ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të Dekretit nr.11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës, ka përmbushur një detyrim ligjor në ushtrim të kompetencave administrative.

Në këto kushte, referuar në nenin 110 të KPA-së, ku parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston*”, Kolegji çmon se shkak i pretenduar nga paditësi nuk ekziston dhe për rrjedhojë pretendimi i tij për çregjistrim është i pabazuar.

Më tej, Kolegji Zgjedhor vëren se Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë të drejtën e subjekteve zgjedhore për t’u tërhequr nga procesi zgjedhor, pas regjistrimit përfundimtar të tyre. Kodi Zgjedhor i njeh subjektit zgjedhor, si dhe koalicionit (ASE), vetëm të drejtën për të propozuar kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore dhe kandidatët e këshillave bashkiakë, por jo atë të tërheqjes së kandidatëve apo të subjekteve zgjedhore, pas regjistrimit të tyre.

Kodi Zgjedhor ka përcaktuar procedura dhe afate të qarta dhe urdhëruese lidhur me propozimin, verifikimin dhe regjistrimin e kandidatëve për zgjedhje. Këto rregullime ligjore kanë për qëllim të garantojnë stabilitetin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor nga vonesa apo veprime që e vënë në rrezik atë.

Në mënyrë të veçantë, urdhërimi ligjor i parashikuar në nenin 74, pika 4, të Kodit Zgjedhor, që ndalon shprehimisht ndryshimin e emrave në listat shumememore pas miratimit përfundimtar të tyre nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, synon të garantojë realizimin e një procesi zgjedhor transparent, në respektim të parimeve themelore të së drejtës zgjedhore, duke siguruar ushtrimin nga zgjedhësit të së drejtës themelore të tyre për të zgjedhur personat që do t’i qeverisin ata në nivel vendor.

Parimi i votimit të lirë (neni 45/3 i Kushtetutës), element i të cilit është liria e zgjedhësve që, nëpërmjet rrjedhës normale të procesit zgjedhor të mund të formojnë rregullisht opinionin e tyre për të pasur mundësinë që me votë të shprehim preferencën ose pëlqimin për njërën prej alternativave që ofrojnë subjektet zgjedhore, mund dhe duhet të realizohet nëpërmjet paraqitjes dhe njohjes së zgjedhësve me kandidatët e regjistruar dhe programet e tyre, proces që mbart në

vetvete përgjegjësinë e kandidatit të regjistruar dhe koalicionit zgjedhor për një sjellje në funksion e pajtim të përmbushjes së këtij parimi.

Tërheqja/çregjistrimi apo zëvendësimi i kandidatëve nga subjektet zgjedhore, pas miratimit dhe shpalljes së listave dhe regjistrimit të kandidatëve apo, më tej, edhe pas përgatitjes së materialit zgjedhor përkatës do të përbënte një rrezik për stabilitetin dhe transparencën e procesit zgjedhor dhe ushtrimin e të drejtës themelore të votës nga ana e zgjedhësve. Është pikërisht kjo arsyeja që, në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, ka çuar ligjvënësin të mos parashikojë të drejtën e subjektit / koalicionit zgjedhor për të tërhequr kandidatët e regjistruar për kryetar bashkie apo për këshillat bashkiakë.

Kolegji Zgjedhor çmon se mungesa e një rregullimi specifik për tërheqjen e subjektit zgjedhor pas regjistrimit të tij rregullisht nuk duhet të interpretohet sikur ligji (Kodi Zgjedhor) njeh dhe lejon ushtrimin e këtyre të drejtave për sa kohë nuk i kufizon apo ndalon shprehimisht ato. Mungesa e një rregullimi specifik në Kodin Zgjedhor për të drejtat e si më lart përmendura, të çon në përfundimin se subjekteve zgjedhore nuk u janë njohur këto të drejta, duke vlerësuar se kjo mënyrë të kuptuari është më afër qëllimit të ligjvënësit, sikundër edhe në përputhje me interesin publik që mbart procesi zgjedhor, krahas rregullshmërisë së tij, në të kundërt, nëse qëllimi i ligjvënësit do të kishte synuar për njohjen e këtyre të drejtave, atëherë, për vetë rregullshmërinë e vetë procesit zgjedhor, të drejtat në fjalë do të ishin parashikuar shprehimisht në ligjin zgjedhor, përveç se do të ishin parashikuar edhe afate rigoroze, brenda të cilave këto të drejta mund të ushtroheshin, afate këto të tilla që të mos dëmtonin apo pamundësonin realizimin e një procesi zgjedhor në respektim të parimeve bazë të së drejtës zgjedhore, pra zgjedhje universale, të barabarta, të lira, të fshehta, të drejtpërdrejta dhe periodike.

Sa më sipër është shprehur edhe më herët nga Kolegji Zgjedhor, e konkretisht nëpërmjet vendimit nr. 22, datë 20.06.2015, si edhe të vendimit nr.18, datë 05.06.2015.

Kolegji Zgjedhor ndërkohë që e gjen të bazuar vendimmarrjen e KQZ-së, e vlerëson si të pabazuar në ligj kërkesëpadinë e paraqitur nga Partia e Unitetit Kombëtar e si e tillë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenet 158 pika 1 germa “b”, pika 3 dhe pika 5 të Kodit Zgjedhor;

V E N D O S I

- x Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia e Unitetit Kombëtar.
- x Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

Tiranë më 24.06.2019.

ANËTAR
Artur MALAJ
dv.

ANËTAR
Shkelqim Mustafa
dv.

KRYESUES
Tomor SKRELI
dv.

ANËTARE
Lindita Sinanaj
(mendim paralel)
dv.

ANËTAR
Ridvan HADO
(mendim paralel)
dv.

Vertetohet njesia me origjinalin

KANCELARE
Lertida BALILI

MENDIM PARALEL

Unë *gjqytarja Lindita SINANAJ*, në cilësinë e anëtares të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e caktuar në përbërje të trupit gjykues për gjykimin e çështjes që i përket palës paditëse Partia Uniteti Kombëtar, të paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe objekt kundërshtimin e vendimit nr. 836 datë 13.06.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, shpreh mendimin tim kundër arsyetimit të vendimit Nr. 12 datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor lidhur me çështjen.

Vlerësoj se drejtë ka konkluduar trupi gjykues duke rrëzuar padinë e paraqitur, por jam kundër shkaqeve për të cilat shumica e trupit gjykues ka disponuar rrëzimin e padisë. Fillimisht, theksoj faktin se pala paditëse me padinë në gjykim ka parashtruar kërkesimet e saj kundër veprimtarisë së palës së paditur, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, duke kundërshtuar vendimin e këtij Komisioni që ka rrëzuar kërkesën e palës paditëse për çrregjistrimin nga zgjedhjet për pushtetin vendor. Konkretisht në pretendimet e parashtruara në kërkesëpadinë e paraqitur paditësi parashtron se: *“Në datën 13.06.2019, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën tonë, pa respektuar të drejtën tonë materiale dhe proceduriale për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të konkuruar konform dispozitave ligjore, si dhe për tu tërhequr prej tyre kur procesi deformohet prej Kryetarit të Shtetit, në mënyrë arbitrare me vendimin e datës 13.06.2019 vendosi: “Rrëzimin e kërkesës” Vendimi i KQZ-së në vlerësimin tonë është një akt i marrë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë dhe të Kodit Zgjedhor, pasi kushdo subjekt merr pjesë në zgjedhje, voton dhe garon lirisht, sikurse tërhiqet po lirisht prej tyre, posaçërisht në kushtet kur procesin zgjedhor e deformojnë dhe e çënojnë institucionet e rëndësishme të shtetit, sikurse është Presidenti i Republikës. Vendimarrja e KQZ-së duket se detyron elektoratin dhe vetë subjektin zgjedhor kërkues, Partinë e Unitetit Kombëtar, që të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019, ndërkohë që gara për zgjedhjet e pushtetit vendor duhet të jetë e lirë dhe jo detyruese”*

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara nga pala paditëse konstatoj se nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë fakti nëse paraqitja e kërkesës për çrregjistrimin nga

zgjedhjet është rrjedhojë e vullnetit të lirë e të pavarur të subjektit politik, palë paditëse në gjykim, apo është e lidhur me nxjerrjen nga Presidenti i Republikës të Dekretit nr. 11199 datë 10.06.2019, për anulimin e datës së zgjedhjeve. Në këto rrethana vlerësoj se ***pretendimet e palës paditëse duhet të merren në shqyrtim në të dy këto këndvështrime, pra duke konsideruar paraqitjen e kërkesës për çrregjistrim nga procesi zgjedhor si vullnet të lirë e të pavarur të subjektit politik, palë paditëse në gjykim, dhe më tej, duke konsideruar paraqitjen e kërkesës si të detyruar nga dalja e Dekretit përkatës.***

Për të arritur në një konkluzion të drejtë lidhur me sa më sipër vlerësoj të analizoj se referuar parashikimeve të pikës 1 të nenit 9 të Kushtetutës “*Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.*” Sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë e më tej në Kodin Zgjedhor, sistemi elektoral në Republikën e Shqipërisë, është sistemi proporcional. Tek sistemi i përfaqësimit proporcional, mandatet ndahen në mënyrë proporcionale me numrin dhe përqindjen e votave, që fitojnë partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhje. Ky sistem mundëson ndarjen e mandateve midis partive politike në varësi nga numri i votave të fituara në njësinë e caktuar zgjedhore. Pikërisht për këtë shkak Kodi Zgjedhor ka përcaktuar të drejtën e paraqitjes së kërkesës për t’u regjistruar si subjekte zgjedhore për partitë politike, koalicionet e partive politike ose çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që propozohet nga një grup zgjedhësish sipas parashikimeve në Kod. Në këtë mënyrë, parlamenti apo organi i vetëqeverisjes vendore shndërrohet në një lloj pasqyre politike të rrymave të ndryshme të zgjedhësve.

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës dhe midis të tjerave ky mision arrihet edhe nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhjet e përgjithëshme dhe vendore. Konkretisht neni 1 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon se: “*Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve, e të pikpamjeve ose të interesave të përbashkët politikë, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.*” Pra, ligji ka parashikuar në mënyrë të shprehur se synimi për të cilin krijohen partitë politike është ndikimi në jetën e vendit dhe ky ndikim ushtrohet nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje. Parë në këtë këndvështrim, ligjvënësi në përcaktimin e të drejtave të

subjekteve politike lidhur me procesin zgjedhor, është bazuar në logjikën ligjore se partitë do të përmbushin misionin për të cilin janë krijuar dhe në mënyrat dhe mjetet e parashikuara në ligj për përmbushjen e këtij misioni, pra nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje. Një konkluzion i tillë gjën pasqyrim edhe në parashikimet e nenit 2 të ligjit përkatës ku parashikohet se: *“Partite politike marrin pjese ne formimin e vullnetit politik te popullit ne te gjitha fushat e jetes publike dhe kryesisht nepermjet: ... c) pjesemarrjes ne zgjedhjet e pergjithshme dhe vendore.”* Por, theksoj se pjesmarrja në zgjedhje është forma nëpërmjet të cilës partitë politike ndikojnë në jetën e vendit, por kjo nuk presupozon faktin se pjesmarrja në zgjedhje është detyrim.

Në analizë të gjithë kuadrit ligjor, si ligjit “Për partitë politike” edhe Kodit Zgjedhor, rezulton se pjesmarrja në zgjedhje është e drejtë, por e drejtë që duhet realizuar në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor lidhur me afatet, procedurën, etj. Konkretisht neni 63 pika 1 i Kodit Zgjedhor parashikon se: *“Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.”* Neni 64 i Kodit Zgjedhor parashikon se: *“1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për tu rregjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve. 2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ:”*

Referuar dispozitave të mësipërme është e dukshme se rregjistrimi i partive politike si subjekte zgjedhore bëhet mbi kërkesën e paraqitur prej tyre, pasojë e vullnetit të lirë e të pavarur për të ndikuar në jetën politike të vendit duke marrë pjesë në zgjedhje nëpërmjet paraqitjes së një liste kandidatësh. Por, Kodi Zgjedhor konstatohet të ketë parashikuar edhe procedurë për shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga partia politike. Konkretisht neni 73 parashikon se: *“1. KQZ-ja, ose sipas rastit KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korigjim, jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve. 2. Dokumentacioni i korigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.”* Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, si dhe të neneve 72 e 73 të Kodit Zgjedhor, Kolegji

Zgjedhor vlerëson se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, me paraqitjen e listave të kandidatëve dhe koalicioneve të partive, ka detyrimin të verifikojë rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe brenda 48 orëve nga paraqitja e dokumentacionit, merr vendim për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar. Pra, regjistrimi i subjektit zgjedhor bëhet me vendim të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, fakt i cili gjen pasqyrim në mënyrë të shprehur në ligj. Edhe në rastin në gjykim konstatohet se KQZ me vendimin nr. 37 datë 11.03.2019 ka regjistruar Partinë e Unitetit Kombëtar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pushtetit vendor të datës 30.06.2019.

Por, në analizë të gjithë parashikimeve të Kodit Zgjedhor, nuk rezultojnë të jetë parashikuar në mënyrë të shprehur e drejta e subjekteve zgjedhore për t'u tërhequr nga pjesmarrja në zgjedhje. Një mungesë e tillë mendoj se nuk është harresë nga legjislatori, por është e lidhur me atë çfarë u analizua më sipër, lirinë e vullnetit për të garuar në zgjedhje. Pikërisht për këtë shkak, ligjvënësi nuk ka parashikuar ndjekjen e ndonjë procedurë të caktuar apo afateve të caktuara për t'u tërhequr nga pjesmarrja në zgjedhje. Në kushtet kur subjekti zgjedhor për interesa të tij politike, apo rrethanave të tjera, nuk synon të vijojë më tej pjesmarrjen në zgjedhje, në çdo kohë është i lirë të tërhiqet pa patur asnjë detyrim ligjor për të ndjekur ndonjë procedurë të caktuar apo për të respektuar afate të caktuara. Mjafton vetëm deklarimi pranë institucioneve përkatëse të administrimit të procesit zgjedhor i vullnetit për të mos marrë pjesë në zgjedhje, si dhe bërja publike e këtij deklarimi pa qënë e nevojshme konstatimi i çrregjistrimit me ndonjë akt të veçantë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Zbatimi i procedurave dhe i afateve është detyruar vetëm në rastin e parashikimit shprehimisht në ligj, rrethanë e cila nuk konstatohet në rastin e tërheqjes së kërkesës për të marrë pjesë në zgjedhje. ***Parë në këtë këndvështrim, vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve lidhur me rrëzimin e kërkesës për çrregjistrim si subjekt zgjedhor, nuk passjell asnjë pasojë për palën paditëse, pasi sikurse u analizua më sipër, pjesmarrja në zgjedhje është e drejtë dhe nuk mund të detyrohet asnjë subjekt zgjedhor të qëndrojë në këtë garë tej vullnetit të tij.***

Lidhur me faktin se PUK është renditur si subjekt zgjedhor në fletët e votimit për kandidatët për këshillat bashkiak, vlerësoj se është një element teknik që i përket fazës së përgatitjes së

dokumentacionit zgjedhor dhe nuk mund të imponojë vullnetin e subjektit politik për të vijuar pjesmarrjen në zgjedhje. Theksoj se koncepti i çrregjistrimit si subjekt zgjedhor është i ndryshëm nga fshirja e emrit të subjektit nga fleta e votimit, kjo e fundit është pasoja e tërheqjes nga gara zgjedhore, por nuk është element detyrues për të konfirmuar humbjen e cilësisë së subjektit zgjedhor.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, lidhur me pretendimin e palës paditëse për paraqitjen e kërkesës për çrregjistrim si subjekt zgjedhor nga pala paditëse, imponuar nga dalja e Dekretit nr. 11199 datë 10.06.2019 për anulimin e datës së zgjedhjeve, vlerësoj se, ashtu sikurse u arsyetuar më sipër, humbja e statusit të subjekt zgjedhor nuk mund të bëhet për asnjë arsye, përveçse për shkak të vullnetit të lirë të subjektit politik, e vullneti nuk mund të quhet i lirë kur diktohet nga faktorë të jashtëm, qoftë kjo edhe nga dalja e akteve që ndikojnë procesin zgjedhor. Për më tepër, gjatë gjykimit nuk u provua se si ka ndikuar dalja e Dekretit në fjalë dhe përmbajtja e tij, në formësimin e vullnetit të palës paditëse, PUK, për të mos marrë pjesë në zgjedhje.

Duke analizuar sa më sipër, vlerësoj se në kushtet kur pala paditëse PUK i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor duke kërkuar vetëm kundërshtimin e vendimit nr. 836 datë 13.06.2019 të KQZ-së “*Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Uniteti Kombëtar për çrregjistrimin nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019*”, mungon interesi i ligjshëm nga pala paditëse për ngritjen e kësaj padie. Padia, si e drejtë procedurale, ndryshon nga padia si e drejtë substanciale apo, sikurse njihet, padia në kuptimin material. Padia në kuptimin material është e drejta për të kërkuar me anë të gjykatës realizimin e një kërkimi, që buron nga një e drejtë subjektive, është e drejta që ka një person për të kërkuar realizimin me anë të forcës, të një të drejte subjektive, kundrejt një personi tjetër, pavarësisht nga vullneti i këtij të fundit. Padia në kuptimin procedural është mjeti juridik me anën e të cilit personat e interesuar, si dhe ata të autorizuar me ligj, i drejtohen gjykatës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike dhe për mbrojtjen e të drejtave legjitime. ***Paditësi, nëpërmjet padisë, synon dhënien e një vendimi gjyqësor konkret që ai e quan të mundur juridikisht për t’u zbatuar dhe të aftë për të larguar ose hequr situatën antiligjore të pretenduar prej tij.***

Pika 2 e nenit 42 të Kushtetutës, parashikon se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj.” Referuar parashikimeve të kësaj dispozite, në lidhje me termin “kushdo” vlerësohet se në të përfshihen ato subjekte që jo vetëm mund të ngrenë një padi, por që janë edhe titullarë të së drejte materiale duke iu referuar një situatë të caktuar dhe konkrete dhe që synojnë të arrijnë një gjykim mbi vete themelin e pretendimit të tyre, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Padia ka për garanci kushtetuese të drejten e përgjithshme për t’iu drejtuar gjykatës, por vetë padia nuk është aspak e përgjithshme. Përkundrazi, padia duhet t’i referohet një situatë konkrete për të provuar cënimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm.

Në vijim, sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme. E drejta e ngritjes së padisë lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës që e ngre atë padi, interes që ka të bëjë me njohjen ose rivendosjen e një të drejte që i mohohet ose shkelet nga një palë tjetër e tretë, gjë të cilën paditësi mund ta realizojë e mbrojë nëpërmjet investimit, “ndërhyrjes” së gjykatës (Vendimi nr. 91, date 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

Sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor: “1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cënojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. 2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në

Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi. 3. Të drejtën e ankimit sipas këtij neni e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.”

Funksionimi i Kolegjit Zgjedhor është parashikuar në Kodin Zgjedhor i cili parashikon zgjedhjen, përbërjen, organizimin, kategorinë e ankimeve që shqyrtohen prej këtij kolegji, subjektet që legjitimohen në paraqitjen e ankimeve në Kolegjin Zgjedhor dhe procedurën e gjyqimit të ankimeve. Referuar parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, konstatohet se Kolegji shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për sa ky Komision ka ushtruar funksionet e tij në fushën e administrimit të zgjedhjeve.

Në referim të kriterëve të nenit 145 të Kodit Zgjedhor të cituar më sipër, duhet të merret në shqyrtim legjitimiteti aktiv i palës paditëse në ngritjen e padisë në gjykim. Është pikërisht kjo dispozitë që parashikon rrethin e subjekteve që mund ti drejtohen Kolegjit Zgjedhor duke kundërshtuar veprimtarinë e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor. Duke iu referuar parashikimeve të kësaj dispozite (nenit 145), rezulton se pala paditëse, në cilësinë e subjektit zgjedhor, përfshihet në rrethin e subjekteve që legjitimohen ti drejtohen Kolegjit Zgjedhor, por dispozita në fjalë ka parashikuar si kusht të lidhur me legjitimitetit edhe cënimin e interesit të ligjshëm nga vendimet e KQZ-së. Ashtu sikurse u arsyetua edhe më sipër, ***vijimësia e pjesmarrjes në zgjedhje e subjekteve zgjedhore është akt vullneti. Tërheqja nga pjesmarrja në zgjedhje nuk i nënshtohet asnjë detyrimi për tu bërë në ndonjë formë të caktuar, apo për të zbatuar afate apo procedura të caktuara. Parë në këtë këndvështrim, marrja në shqyrtim e ligjshmërisë së vendimit të KQZ-së objekt kundërshtimi nuk passjellë asnjë pasojë që të imponojë qëndrimin e palës paditëse në garën zgjedhore, përsa***

mungon vullneti për të marrë pjesë në zgjedhje. Nëse pala paditëse ka vullnet të vijoj garën elektorale është e lirë të vijojë, në rast të kundër mjafton deklarimi i tërheqjes nga pjesmarrja në zgjedhje dhe tërheqja e kandidatëve të propozuar prej saj. Pra, ushtrimi i të drejtës së subjektit politik palë paditëse në gjykim, për të marrë pjesë në zgjedhje, dhe realizimi i të drejtës për tu zgjedhur për kandidatët e propozuar prej saj, është pasojë e vullnetit të këtij subjekti dhe e kandidatëve të propozuar prej saj, e pandikuar kjo nga asnjë vendimarrje e KQZ-së, apo edhe e vetë Kolegjit Zgjedhor. Për pasojë vlerësoj se palës paditëse nuk i është cënuar interesi i ligjshëm i pretenduar lidhur me lirinë e pjesmarrjes në zgjedhje, e për pasojë nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie.

Veç sa është analizuar më sipër, lidhur me legjitimitimin e palës paditëse për ngritjen e padisë në gjykim, konstatohet se në padinë e paraqitur, si edhe në gjykim, përfaqësuesi i palës paditëse ngriti pretendime që lidhen me ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 11199 datë 10.06.2019 që ka anuluar datën e zgjedhjeve. Në të kundërt nga sa ka analizuar shumica e trupit gjykues, vlerësoj se referuar parashikimeve të nenit 145 të Kodit Zgjedhor të cituar më sipër, Kolegji Zgjedhor nuk ka kompetencën të marrë në shqyrtim këto pretendime.

Funksionimi i Kolegjit Zgjedhor është parashikuar në Kodin Zgjedhor i cili parashikon edhe kategorinë e ankimeve që shqyrtohen prej këtij Kolegji dhe procedurën e gjykimit të tyre. Lidhur me kompetencën, referuar parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, konstatohet se Kolegji shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për sa ky Komision ka ushtruar funksionet e tij në fushën e administrimit të zgjedhjeve. Pika 7 e nenit 2, të Kodit Zgjedhor, përcakton se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është organi më i lartë shtetëror, i përhershëm, i ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Theksoj se jo, çdo vendimarrje e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është objekt shqyrtimi në Kolegjin Zgjedhor, i cili mbi ankimin e subjekteve të parashikuara në Kodin Zgjedhor, është ngarkuar me detyrimin për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të KQZ-së, të dhëna vetëm në kuadër të kompetencave me të cilat e ka ngarkuar Kodi Zgjedhor këtë

institucion, pra kundër vendimeve të dhëna në fushën e administrimit të procesit zgjedhor, sipas parashikimeve të vetë Kodit Zgjedhor. *Më tej, qoftë edhe në funksion të ndikimit në procesin zgjedhor, Kolegji Zgjedhor nuk ka kompetencë të marrë në shqyrtim veprimtarinë e asnjë institucioni tjetër, apo akte të nxjerra nga institucione të tjera.* Për pasojë, edhe referimi i arsytimit të shumicës së trupit gjykues në parashikimet e vendimit nr. 150 datë 16.06.2017 të Kolegjit prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Kushtetuese, është i pabazuar. Është e vërtetë se në vendimin e mësipërm është arsyetuar se *“Përputhja apo jo e dekretit të Presidentit të Republikës me dispozitat e Kodit Zgjedhor nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në juridiksionin e gjykatave administrative apo, sipas rastit, të Kolegjit Zgjedhor dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë.”*, por Kolegji Zgjedhor në rastin konkret nuk ka objekt shqyrtimi ligjshmërinë e veprimtarisë së Presidentit të Republikës në nxjerrjen e Dekretit Nr. 11199 datë 10.06.2019 dhe as nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë veprimtari në kuadër të këtij procesi. Ashtu, sikurse analizova më sipër, pretendimet e palës paditëse janë të fokusuar në kundërshtimin e vendimarrjes së KQZ-së, lidhur me deformimin e vullnetit të palës paditëse për të mos u çregjistruar nga zgjedhjet.

GJYQTARE

Lindita SINANAJ

dv.

MENDIM PARALEL

Unë gjyqtari Ridvan Hado, parashtroj këtë mendim paralel në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së Kolegjit Zgjedhor në çështjen me paditës Partia Uniteti Kombëtar dhe të paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, me objekt kundërshtimin e vendimit nr.836, datë: 13.06.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Me vendimin nr.12, datë: 24.06.2019 Kolegji Zgjedhor vendosi: “Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia e Unitetit Kombëtar.”

Duke qenë dakord me dispozitivin e vendimit, pasi është e vetmja mënyrë sesi mund të zgjidhej kjo çështje, referuar llojeve të vendimmarrjes që mund të disponojë Kolegji Zgjedhor në referim të nenit 158 të Kodit Zgjedhor, ndaj mendim të kundërt në lidhje me arsyet e rrëzimit të padisë.

Me vendimin nr.836, datë: 13.06.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve i është rrëzuar kërkesa paditësit për çregjistrim nga zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, me arsyetimin se këto zgjedhje janë konform Kushtetutës dhe ligjit dhe dekreti nr.11199, datë: 10.06.2019 i Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit të mëparshëm të datës 05.11.2018, që caktonte datën e zgjedhjeve më 30 qershor 2019, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Ndonëse zgjidhja që i ka dhënë KQZ kërkesës së paditësit Partia e Unitetit Kombëtar është e bazuar në ligj, arsyetimi i këtij organi nuk është në pajtim me kompetencat e tij sipas Kodit Zgjedhor. Kjo pasi nuk është atribut që i njihet nga Kodi Zgjedhor KQZ-së, vlerësimi i fuqisë juridike të Dekreteve të Presidentit të Republikës. Këtë atribut, ndryshe nga sa argumenton shumica, nuk e ka as Kolegji Zgjedhor. Dekreti i Presidentit të Republikës si akt kushtetues e ligjor, nuk mund të jetë objekt gjykimi (as incidental) pranë Kolegjit Zgjedhor, pasi vetë Kodi Zgjedhor nuk e ka parashikuar këtë. Dekreti i Presidentit të Republikës si akt administrativ kolektiv në kuptim të nenit 3, pika 1, gërma b e Kodit të Procedurave Administrative, nuk është parashikuar si objekt kundërshtimi në KQZ apo Kolegji Zgjedhor. Shumica arsyeton se dekreti i Presidentit të Republikës si akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm dhe mund të konstatohet si i tillë nga KQZ dhe Kolegji Zgjedhor. Në lidhje me këtë, në referim të neneve 17, pika 1, gërma c dhe 40, pika 1, gërma c, të ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, qartësisht nuk hyn në sferën e kompetencave të Kolegjit Zgjedhor shqyrtimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ kolektiv. Këtë të drejtë madje nuk e ka as KQZ.

Vlerësimi nëse Presidenti i Republikës mund të shfuqizojë Dekretin e mëparshëm të tij, mbështetur në dispozitat e Kushtetutës që i njohin atij të drejtën për të nxjerrë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, apo mbështetur në nenet 113, pika 2 dhe 116, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, nuk është çështje që i përket Kolegjit Zgjedhor. Vlerësimi i arsyeve se përse Presidenti i Republikës ka anuluar datën e zgjedhjeve, siç u përmend më sipër, nuk është tagër i Kolegjit Zgjedhor, i cili nuk vepron as si Gjykatë Kushtetuese e as si gjykatë administrative, por është gjykatë sui generis, e krijuar me ligj të veçantë. Kolegji Zgjedhor nuk ka kompetenca ligjore sipas Kodit Zgjedhor për vlerësimin qoftë edhe incidental të pavlefshmërisë së Dekretit që cakton datën e zgjedhjeve apo e shfuqizon atë. Ndaj pavarësisht nëse dekreti i Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit të mëparshëm për caktimin e datës së zgjedhjeve më 30 qershor 2019, është ose jo i pavlefshëm, kjo nuk ndikon në rrëzimin e padisë së paditësit Partia e Unitetit Kombëtar.

Nëse Dekreti i Presidentit për shfuqizimin e datës së zgjedhjeve vendore, është absolutisht i pavlefshëm, atëherë paditësi nuk legjitimohet të kërkojë çregjistrimin, pasi në referim të nenit 73,

pika 4 e Kodit Zgjedhor, ai është jashtë afateve ligjore për të kërkuar këtë gjë. Mirëpo, siç theksova edhe më sipër, Kolegji Zgjedhor dhe KQZ-ja, nuk kanë tagër kushtetues dhe ligjor për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të dekreteve të Presidentit të Republikës, pasi konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një dekreti të kësaj natyre, mund të bëhet vetëm në rrugë të posaçme gjyqësore. Nëse kompetent për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Dekretit të Presidentit të Republikës është Gjykata Kushtetuese apo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nuk është çështje që mund të ngrihet dhe të zgjidhet nga Kolegji Zgjedhor, pasi para këtij kolegji nuk është paraqitur ndonjë padi kundër dekretit të Presidentit të Republikës. Për rrjedhojë Kolegji Zgjedhor nuk mund të shprehet për një problematikë që nuk është paraqitur konform ligjit para tij.

Ndaj vlerësoj se rrëzimi i padisë së paditësit Partia e Unitetit Kombëtar është zgjidhja e vetme e kësaj çështje, por për arsyet e sipërcituara dhe jo për ato të parashtruara nga shumica në vendimin përfundimtar.

GJYQTAR

RIDVAN HADO
dv.